

# **NJOFTIM PUBLIK PËR DORËZIM TË FTESAVE – TV GURRA**

**Shkup, 16 qershor 2022.** – Bazuar në nenin 56 paragrafi 1 dhe paragrafin 5 nga Ligji për shkelje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.96/19), dhe në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 alinea 4 dhe nenin 23 paragrafin 1 alinea 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, ka kryer:

## **NJOFTIM PUBLIK PËR DORËZIM TË FTESAVE**

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencioni) njofton personin fizik Salif Rizaj nga Kërçova, me adresë vendbanimi në f.Trapçin Doll, Kërçovë si person përgjegjës i programit të personit juridik, Shoqëria tregtare radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për Ftesat e përgatitura numri i yni ark.nr.03-2145/3 nga 27.05.2022 dhe numri i yni ark.nr.03-2146/3 nga 27.05.2022 për zbatimin e procedurës për paqësim, për të cilën në dy raste (më datën 27.05.2022 dhe më 07.06.2022), Agjencia nuk arriti të bëjë një dërgesë të rregullt (letrat në dy raste u kthyen nga A.D. Posta e Maqedonisë së Veriut me tregues „i shpërngulur“).

– I bëhet thirrje personit fizik Salif Rizaj nga Kërçova me adresë vendbanimi në f.Trapçin Doll, Kërçovë, në cilësinë e palës (person përgjegjës i programit të personit juridik) brenda 8 (tetë) ditësh nga dita e shpalljes, të paraqitet në ambjentet e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, me seli në rrugën. „Makedonija“ nr.38, Pallati Panko Brashnarov 1000 Shkup, për pranimin e ftesave të

mësipërme për zbatimin e procedurave për paqësim, çdo ditë pune prej orës 8:00 deri më 16:00.

– Kjo paraqitje e ftesave dhe shpallja publike në web faqen e Agjencisë, konsiderohet si paraqitje e rregullt me shkrim, në pajtueshmëri me nenin 56 paragrafi 5 nga Ligji për kundërvajtje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.96/19).

**Njoftimi publik për dorëzim të ftesave është i disponueshëm në linkun e radhës**